dh)Operatori ekonomik duhet te paraqesi CV e Drejtuesve Teknike, kontrate pune si dhe libreze pune, te figurojne ne licensen e shoqerise pasi mosqenia ne licensen e shoqerise e drejtuesit teknik eshte kusht skualifikues, si dhe një deklarate e cila përcakton se Drejtuesi Teknik është i punësuar pranë kësaj shoqërie me kohë të plotë pune dhe do jetë në dispozicion të realizimit të objektit.

e) Operatori ekonomik duhet te kete minimalisht:

Dokumentat standarde të tenderit

- nje inxhinier mekanik (drejtues teknik)
- nje inxhinier mjedisi
- nje inxhinier elektrik

Inxhinieri Elektrik dhe Inxhinieri i Mjedisit nuk eshte e domosdoshme qe te jene drejtues teknikë.

ë) Operatori duhet të ketë çertifikatën ISO 9001:2008 ose ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

f) Operatori, duhet të ketë çertifikatën ISO 14001:2004 ose ISO 14001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të ambientit” në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

g) Operatori, duhet të ketë çertifikatën ISO BS OHSAS 18001:2007 mbi “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë te punetoreve ne pune” lëshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

h) Operatori ekonomik duhet te kete Leje Mjedisore te tipit C per aktivitetin ”montim te tubave per aspirim dhe kondicionim” .

i) Operatori Ekonomik ofertues duhet të dëshmoje se ka ne pronesi ose qira mjetet e pajisjet teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, si me poshte :

Lloji i makinerise (pajisjes)	Njesia	Sasia
Furgona	cope	2
Saldatrice	cope	1
Matrapik	cope	2
Shkalle te levizshme	cope	2
Trapan	cope	2
Gur fresibel	cope	2
Skele metalike	cope	1

- Makinerite - pajisjet ne pronesi te shoqerohen me akt pronesie origjinal ose kopje te noterizuara (kontrata shitblerje ose kontrata dhurimi).
- Makinerite - pajisjet me qira te shoqerohen me kontrate qiraje si dhe me aktin e pronesise se qiradhenesit (origjinal ose kopje e noterizuar).
- Per mjetet qe shenohen ne regjistra publike duhet te paraqitet dokumenti qe

Dokumentat standarde të tenderit

verteton regjistrimin (leje qarkullimi, akt kolaudimi, siguracion, taksat vjetore, leje transporti minimalisht për 1 automjet (furgon) dhe çertifikaten e pronesisë së mjedit). Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat e blerjes – kopje e noterizuar.

j) Autodeklarate nga ofertuesi që të gjitha materialet që përdoren për riparime dhe furnizim vendosje, do të jenë të çertifikuara (CE).

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Loti 4. “Riparim-mirëmbajtje sisteme ajri të vakumuar, komprimuar dhe linjat përkatëse; tanker oksigjeni; rampa oksigjeni dhe linjat e paisjet përkatëse, të QSUT-së”.

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;

b. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit, sipas Shtojcës 6;

c. Formulari i Ofertës, sipas Shtojcës 1;

ç. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri

(Shënim: Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezultojnë se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë).

d. Lista e informacionit konfidencial sipas Shtojcës 4.

3. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

3.1 Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Operatori ekonomik duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit të përcaktuara në shtojcën 8.

3.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

a) Kopje të vërtetuara të bilanceve të tre viteve (2015, 2016 dhe 2017) të operatorit ekonomik pjesëmarrës, të paraqitura në autoritetet përkatëse dhe të konfirmuara nga ky autoritet.

b) Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar në 3 (tre) vitet e fundit (2015, 2016 dhe 2017) ku vlera mesatare duhet të jetë në shumën prej 40% të vlerës së lotit/lotëve përkatës/e, për të cilin oferton operatori ekonomik.

3.3 Për kapacitetin teknik:

a) Shërbime të ngjashme në një vlerë sa 40 % e vlerës së fondit limit të lotit/lotëve për të cilin oferton operatori, të kryera gjatë tri viteve të fundit.

-Për kontratat e realizuara me institucione publike duhet të paraqesë kontratën/kontratat përkatëse të shoqëruar me vërtetimin e realizimit me sukses të saj/tyre nga autoriteti kontraktor (ku të shprehen qarte datat, shumat dhe shërbimet e realizuara).

-Për kontratat e realizuara me subjekte private duhet të paraqesë faturat tatimore të shitjes (ku të shprehen qarte datat, shumat dhe shërbimet e realizuara) .

b) Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e kontratës:

Liçensë profesionale e Shoqërisë e vlefshme me kategorinë

o **NS 2-A ;**

c) Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për periudhën Janar - Dhjetor 2017 ku të ketë një punësim mesatar prej 15 punonjës, ku të përfshihet dhe stafi i shoqërisë, të shoqëruara me listëpagesat (formularët E-sig 025 të konfirmuara nga dega e tatimit taksativ të rrethit përkatës, shoqëruar gjithashtu dhe me **formularët e deklaratimit të pagesës të sigurimeve shoqërore dhe TAP për periudhat e më sipërme.**

ç) Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve të tarifave dhe taksave vendore për vitin 2017.

d) Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka të punësuar punonjësit me kualifikime teknike nga inspektoriat Shtetëror Përgjegjës për Sigurinë e Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike ose nga një organ i akredituar certifikues personeli (Grup Certifikues) për fushën përkatëse në specialitetet si më poshtë:

- 2 punonjës elektro-mekanikë
- 2 punonjës saldator me patente ose certifikatë

dh) Operatori ekonomik duhet të paraqesë CV të Drejtuesve Teknikë, kontratë pune si dhe libere pune, të figurojnë në licencën e shoqërisë pasi mosqenia në licencën e shoqërisë e drejtuesit teknik është kusht skualifikues, si dhe një deklaratë e cila përcakton se Drejtuesi Teknik është i punësuar pranë kësaj shoqërie me kohë të plotë pune dhe do jetë në dispozicion të realizimit të objektit.

e) Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht:

- 1 inxhinier mekanik
- 1 inxhinier të kualifikuar për sisteme gazrash mjekësore.

ë) Për mundësimin e këtij shërbimi nevojiten të paktën 2 teknike elektro-mekanike me kontratë pune dhe CV të tyre, për mbulimin 24 orësh të shërbimit të gatishmerisë.

f) Operatori duhet të ketë certifikatën ISO 9001:2008 ose ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

g) Operatori Ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka ne pronesi ose qira mjetet e pajisjet teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, si me poshte :

- Bombël azoti e pajisur me reduktor .
- Saldatrice.
- Pompa vakumi serbatorësh oksigjen (tanker)
- Kanellë saldimi.
- Shkalle alumini me hapje
- Shkalle dyshe e vogel (E vërtetuar me faturë tatimore).

h) Autodeklarate nga ofertuesi qe të gjitha materialet që përdoren për riparime dhe furnizim vendosje, do të jenë të çertifikuara (CE).

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Loti 5. “OSMOZA Riparim Mirëmbajtje e Sistemeve të zbutjes së ujit – osmozës për analizat laboratorike, spitalore në QSUT”.

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Deklaratë mbi përbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;

b. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit, sipas Shtojcës 6;

c. Formulari i Ofertës, sipas Shtojcës 1;

ç. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri

(Shënim: Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë).

d. Lista e informacionit konfidencial sipas Shtojcës 4.

3. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

3.1 Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Operatori ekonomik duhet te plotesoje kriteret e pergjithshme te pranim/kualifikimit te percaktuara ne shtojcen 8.

3.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

a) Kopje të vërtetuara të bilanceve të tre viteve (2015, 2016 dhe 2017) të operatorit ekonomik pjesëmarrës, të paraqitura në autoritetet përkatëse dhe të konfirmuara nga ky autoritet.

b) Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar në 3 (tre) vitet e fundit (2015,

2016 dhe 2017) ku vlera mesatare duhet të jete ne shumen prej 40% te vlerës së **lotit/loteve perkates/e**, për të cilin oferton operatori ekonomik.

3.3 Për kapacitetin teknik:

a) Shërbime të ngjashme në një vlerë sa 40 % e vlerës së fondit limit **te lotit/loteve per te cilin oferton operatori**, të kryera gjatë tri viteve të fundit.

-Për kontratat e realizuara me institucione publike duhet të paraqesë kontratën/kontratat përkatëse të shoqëruar me vërtetimin e realizimit me sukses te saj/tyre nga autoriteti kontraktor (ku te shprehen qarte datat, shumat dhe shërbimet e realizuara).

-Për kontratat e realizuara me subjekte private duhet të paraqesë faturat tatimore te shitjes (ku te shprehen qarte datat, shumat dhe shërbimet e realizuara).

b) Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e kontratës:

Liçensë profesionale e Shoqërisë e vlefshme me kategorine

o NS16-A ;

c) Vertetim nga Drejtoria e Tatimeve per numrin e punonjesve te siguruar per periudhen Janar - 2016 – Shtator 2017 ku te kete nje punesim mesatar prej 6 punonjesish, ku te perfshihet dhe stafi i shoqerise, te shoqeruara me listepagesat (formulet E-sig 025).

ç) Vertetim per shlyerjen e detyrimeve te tarifave dhe taksave vendore per vitin 2017.

d) Operatori ekonomik duhet te deshmoje se ka te punesuar punonjesit me kualifikime teknike nga inspektoriati Shteteror Pergjegjes për Sigurinë e Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike ose nga një organ i akredituar çertifikues personeli (Grup Certifikues) për fushën përkatëse ne specialitetet si me poshte:

- 1 punonjes elektrikist
- 1 punonjes mekanik
- 2 punonjes hidraulik

dh) Operatori ekonomik duhet te paraqesi CV e Drejtuesve Teknike, kontrate pune si dhe libreze pune, te figurojne ne licensen e shoqerise pasi mosqenia ne licensen e shoqerise e drejtuesit teknik eshte kusht skualifikues, si dhe një deklaratë e cila përcakton se Drejtuesi Teknik është i punësuar pranë kësaj shoqërie me kohë të plotë pune dhe do jetë në dispozicion të realizimit të objektit.

e) Operatori ekonomik duhet te kete minimalisht:

- nje inxhinier mjedisi
- nje inxhinier kimik

(Inxhinieri i Mjedisit dhe Inxhinieri Kimik nuk eshte e domosdoshme qe te jene drejtues teknikë.)

ë) Operatori duhet të ketë çertifikatën ISO 9001:2008 ose ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Dokumentat standarde të tenderit

f) Operatori, duhet të ketë çertifikatën ISO 14001:2004 ose ISO 14001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të ambientit” në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vleresimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

g) Operatori, duhet të ketë çertifikatën ISO BS OHSAS 18001:2007 mbi “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë” lëshuar nga një organ i vleresimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

i) Operatori Ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka në pronësi ose qira mjetet e pajisjet teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, si më poshtë :

Lloji i makinerise (pajisjes)	Njesia	Sasia
Furgona	cope	1
Trapan	cope	1
Gur fresibel	cope	1

- Makinerite - pajisjet në pronësi të shoqërohen me akt pronësie origjinal ose kopje të noterizuara (kontrata shitblerje ose kontrata dhurimi).
- Makinerite - pajisjet me qira të shoqërohen me kontratë qiraje si dhe me aktin e pronësisë së qiradhenesit (origjinal ose kopje e noterizuar).
- Për mjetet që shihen në regjistrin publik duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin (leje qarkullimi, akt kolaudimi, siguracion, taksat vjetore, leje transporti minimalisht për 1 automjet (furgon) dhe çertifikatën e pronësisë së mjetit). Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat e blerjes – kopje e noterizuar.

j) Autodeklarate nga ofertuesi që të gjitha materialet që përdoren për riparime dhe furnizim vendosje, do të jenë të çertifikuara (CE).

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 9

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Loti 1: “Riparim-mirëmbajtje e ashensorëve në QSUT”, për vitin 2018

QSUT, ka në inventarin e saj 35 ashensorë dhe 5 dyer mekanike (kundra rrezatimit), sipas pasqyrës që jep të dhëna teknike dhe gjëndjen e tyre teknike.

Shërbimet dhe riparimet, që do të kryhen janë për 27 ashensorë, si dhe për 5 dyer mekanike, të përshkruara në preventivat bashkëngjitur, por në kushte spitalore, ç'ka presupozon që do të kryhen në kohë të përshtatshme, pa penguar lëvizjen e të sëmurëve, dhe me cilësi, gjatë 24 orëve/24 për të gjitha ditët e vitit.

Mirëmbajtja dhe riparimet e ashensorëve, do të kryhen sipas preventivit pjesë përbërëse e kontratës, për zbatimin e së cilës lëshohen "Urdhëra Pune" nga specialistët përkatës të Sektorit Teknik të QSUT, dhe në përfundim të shërbimeve teknike apo riparimeve hartohet procesverbali i marrjes në dorëzim, ku nënshkruajnë të dy/tre palët.

"Urdhëri i Punës" për riparime të defekteve të çastit, shoqërohet me preventiv të hartuar nga përfaqësuesi i QSUT-së, dhe nënshkruhet edhe nga Sipërmarrësi, i cili merr përsipër zbatimin në afat e me cilësi të detyrave të dhëna në "Urdhërin e Punës", me cilësi dhe në kohë.

A. Specifikime teknike

Preventivi përmban zonën e kryerjes së shërbimeve teknike, llojin dhe specifikimin teknik të shërbimit të riparim-mirëmbajtës, njësinë, sasinë, çmimin, vlerën dhe kohën e kryerjes së riparimit të defekteve. Pjesë e preventivit është pasqyra me të dhënat teknike të ashensorëve sipas godinave ku janë të instaluar.

Preventivi me të dhënat e mësipërme është pjesë përbërëse e kontratës.

Të gjitha materialet që përdoren për riparime dhe furnizim vendosje, duhet të jenë të certifikuara (CE).

B. Kërkesat të veçanta teknike:

1. Ofertuesit të njihen me ashensorët dhe të deklarojnë që marrin përsipër kryerjen e këtyre riparimeve dhe shërbimeve mirëmbajtëse në çdo orë dhe me cilësinë e kërkuar për shërbim spitalor.
2. Ofertuesit të kenë persona përgjegjës për kryerjen e riparimit të çdo defekti të mundshëm, duke i deklaruar ato me lidhjen e kontratës.
3. Sipërmarrësi duhet të kontaktojë çdo ditë me përfaqësuesin e QSUT-së, për ndjekjen e zbatimit të kontratës.

C. Vendi i kryerjes së riparim-shërbimeve është:

Në të gjitha Godinat Spitalore të QSUT (ku janë në funksionim ashensorët): Onkologjik, Infektiv, Djegie-Plastikë, Kirurgji e Përgjithshme, Spitali i Ri, Sëmundjet e Brendshme, Kardiokirurgji, Spitali Francez, Pediatri, Neurokirurgji dhe Neurologji, Akseleratori Onkologjik, Akseleratori i Neurokirurgjisë, Qendra e Konsultave .

D. Grafiku i lëvrimit (koha e kryerjes së riparim-shërbimeve):

1. Shërbimet teknike dhe riparimet e planifikuara jepen me “Urdhër Pune”, dhe do të kryhen nga ora 8:30 deri në 20:00, në ditë të shtuna dhe diela, në ditët e pushimit dhe festave zyrtare, pa e penguar kryerjen e shërbimit spitalor.
2. Për rastet e defekteve të çastit (emergjente), riparim-shërbimet do të kryhen me marrjen e njoftimit, menjëherë, çdo ditë dhe në çdo orë.

E. Kohëzgjatja e riparim-shërbimeve, do të jetë nga nënshkrimi deri më 31.12.2018.

Specifikimet teknike

Loti 2 “Riparim-mirëmbajtje e sistemit të furnizimit me energji elektrike, motogjeneratorëve, sistemit të orëve, fonisë dhe sistemit të detektim-sinjalizimit të zjarrit”.

QSUT-ja është një objekt i kategorisë së parë nga shkalla e rëndësisë së vecantë, objektet e këtij loti janë jetik dhe të rëndësishme, pasi janë të lidhur direkt me aktivitetin shëndetësor të shërbimeve mjekësore. Shërbimi i riparimeve, mirëmbajtjes, kontrollit siguron një mbarëvajtje më të mirë e siguri të jetës së të sëmurëve.

Firma e mirëmbajtjes do të kryejë një shërbim, duke zbatuar të gjitha procedurat e nevojshme për këtë shërbim, si shërbimet periodike të mirëmbajtjes sipas grafikut, të shoqëruar me urdhëra përkatës pune, si dhe zëvendësimin e pjesëve të këmbimit me urdhëra pune .

Firma e mirembajtjes do të kryejë shërbimet e nevojshme të mirëmbajtjes javore e mujore, sipas grafikut që do miratohet nga Sektori Teknik.

Qëllimi i kryerjes së shërbimit të riparim-mirëmbajtjes së kabinave elektrike të Qendrës Spitalore Univesitare Nënë Tereza, është që të sigurohet gadishmëria, vazhdimësia në punë në kushte optimale dhe brënda normave dhe sigurimit teknik.

Për riparimin dhe mirëmbajtjen e kabinave elektrike 20/6/0.4 kV, kemi parashikuar zërat:

A. Kontroll, shërbim dhe riparim transformatori 20/6/0,4 kV ku përqendrohet në:

Verifikimin e temperaturës së funksionimit të trasformatorit, kontrolle të vajit, fletëve të ventilatorit, të radiatorit, gjendjes së izolatorëve të tensionit të mesëm dhe të ulët, gjendjes së zgjeruesit, pastrim të dyshemesë nga ndotjet me vaj, etj..

B. Kontroll, kolaudim dhe matje tokëzimi dhe izolacioni ku përqendrohet në:

Në Kabinat elektrike dhe në ambiente të rëndësishme me aparatura, matjet do të bëhen me pajisje të matjeve të izolacionit, të shoqëruar me protokoll tokëzimi përkatës.

C. Verifikim të paneleve të automatikës 0.4 kV në kabinat elektrike me panel automatik, ku përqëndrohet në: Kabinat elektrike të cilat kanë panele të komandimit automatik si: kabina elektrike e Spitalit Nr.1, Nr.2, Pediatri, Neurologjisë dhe Neurokirurgjisë (2 janë të rinj) do të bëhet:

Prova kampion e automatëve diferencial .

Prova kampion e automatëve magneto-termik.

Kontrolli termik i automatëve .

Prova e llogjikës së funksionimit të automatikës.

Verifikimi i funksionimit të llampave të sinjalizimit .

Kontrolli i gjendjes të shkarkuesve të mbitensionit.

Kontrolli i lidhjes të saktë të kapikordave me kolektorin e tokës.

Verifikimi i tokëzimit etj.

D-Veshje të kabllave me mur kartonxhes cimento, ku përqëndrohen në kabinat elektrike e Spitali 6 katësh, Spitali Nr .2 , Pediatri, duke i sistemuar kabllot me mur kartonxhes .

E-F.v vaj transformatori, sipas izolacionit për transformator, punime për përmirësimin e tokëzimit, duke vendosur elektroda zingu me gjatësi 1.5 m dhe tel bakri CU 16-25 mm².

F- F.v. Tabela paralajmëruese, lyreje sipërfaqe metalike, për kabinat elektrike sipas sigurimit teknik.

G-Të karakterit furnizim vendosje kablo CU fleksibël 4 polar për tension 380-400V me seksion M4X35mm², 4X25mm², 4X16mm², 4X10mm², 4X6mm², kokat e kabllave ,kapikorta bakri M35mm², 25mm², 16mm², 10mm², 6mm², për riparime të kabllave ekzistuese sipas nevojave që do të lindin.

H-Furnizim vendosje automatë 4 polar fuqie, 660A, 250A,160A,100A, 43A, për riparime panele 0.4 kv të fuqisë, sipas nevojave që do të lindin .

L-Furnizim vendosje celës me 2 pozicione, 630A ,380-400V mekanik , për kalimin e skemës në mënyrë mekanike .

Firma e mirembajtjes, do të kryejë një shërbim të tillë, duke zbatuar të gjitha procedurat e nevojshme për këtë shërbim, si shërbimet periodike të mirëmbajtjes, sipas grafikut të shoqëruar, si dhe zëvendësimin e pjesëve të ndërrimit bazuar në “urdhëra pune” të lëshuar nga Sektori Teknik.

Firma e mirëmbajtjes do të kryejë shërbimet e nevojshme të mirëmbajtjes javore e mujore.

Qëllimi i kryerjes së shërbimit të riparim mirëmbajtës së motogjeneratorëve të Qendrës Spitalore Univesitare “Nënë Tereza”, është që të sigurohet vazhdimësia në punë në kushte optimale dhe brënda normave teknike dhe sigurimit teknik, si dhe garantimi i gadishmërisë teknike për të bërë të mundur kryerjen e shërbimeve spitalore në të gjithë QSUT.

Për riparimin dhe mirëmbajtjen e motogjeneratorëve, kemi parashikuar zërat të shërbimit dhe mirëmbajtjes të ndarë në 2 natyra: shërbime periodike dhe furnizim vendosje pjesë ndërrimi.

Shërbimi periodik i grupit të gjeneratorëve kosiston në:

Kontroll vizual të gjëndjes së përgjithshme të gjeneratorit,

Kontroll dhe plotësim i nivelit të vajit,

Kontroll i jashtëm i gjëndjes së motorrit,

Kontroll i jashtëm i gjëndjes së gjeneratorit,

Kontroll i tubacioneve të sistemit të furnizimit me karburant,

Kontroll i gjëndjes fizike dhe regjistrimi i rripave të transmetimit të lëvizjes.

Kontroll i kuadrit të automatikës, që pëmbledh kontrollin e sistemit të kontrollit të parametrave dhe atij të komandimit automatik.

Kontroll vizual i serbatorit të lëndës djegëse,

Kontroll i gjeneratorit për shpërndarje ngarkese nëpër fazë

Kontroll i lëngut ftohës në radiator

Kontroll i baterisë: terminaleve, elektrolitit dhe niveli të tensionit të saj.

Testim i gjeneratorit në ngarkesë maksimale.

Ndërrimi i filtrave të vajit, ajrit, naftës për gjeneratorët, të cilët janë pak më të vjetër si dhe furnizim vendosje vaj të tip SAE 30-50, dhe bateri 12 volt me 165A, 100A dhe 65-85 A, sipas nevojave reale dhe grafikut përkatës.

Public Health Sector

Specifikime Teknike

Të sistemit të furnizimit me energji elektrike, sistemit të orëve dhe diktim-sinjalizimit të zjarrit në SPITALIN E RI

Sipërmarrësi do të kryejë riparim-mirëmbajtjen e këtyre sistemeve duke zbatuar të gjitha procedurat e duhura teknike dhe ligjore.

Sipërmarrësi do të realizojë shërbimet periodike të mirëmbajtjes, si dhe zëvendësimin e pjesëve të këmbimit sipas me “Urdhërave të Punës” të lëshuar nga përfaqësuesi i QSUT.

Sipërmarrësi do të kryejë shërbimet e nevojshme të mirëmbajtjes javore e mujore.

Qëllimi i kryerjes së shërbimit të riparim-mirëmbajtjes së kabinës elektrike të Spitalit të Ri është që të sigurohet gadishmëria, vazhdimësia në punë në kushte optimale dhe brënda normave të sigurimit teknik.

Shërbimi i mirëmbajtjes duhet të përqëndrohet në:

Shërbime javore (A1-A11) për periudhën deri më 31/12/2018, shërbimet 3-mujore B1-B2, shërbimet 6-mujore C1-C2.

A/1) Verifikimi i kabinës së transformimit:

Verifikimi i temperaturës së funksionimit të transformatorit dhe kontrole të tjera të lidhjes "A".

Verifikimi i funksionimit të grupit të ndërhyrjes në qarqet ndihmës.

Verifikimi i qarqeve ndihmës.

Verifikimi i funksionimit të nxjerrjes së ajrit dhe termostatit përkatës në ambientin e komandimit.

Verifikimi i gjendjes të dorezave izoluese dhe tapeteve.

Pastrimi i përgjithshëm e ambientit dhe e grilave të shkëmbimit të ajrit.

A/2) Verifikimi i grupit të gjeneratorit si edhe shërbimi periodik i tij:

Prova e ndërhyrjes në automatikë me anë të simulimit të mungesës të rritit OSHEE.

Vënia në punë në mënyre periodike për një kohëzgjatje prej 1 ore për të kontrolluar te gjithë parametrat e nevojshëm të gjeneratorit. Ky veprim do të bëhet me radhë për secilin gjenerator dhe realizohet me "Urdhër Pune " të veçantë.

Stimulimi i lidhjes së 2 gjeneratorëve në paralel, për të rritur shkallën e sigurisë së impiantit.

A/2-2) Shërbimi periodik i grupit të gjeneratorëve:

Ndërrimi i filtrave të vajit, ajrit, naftës dhe të ujit.

Ndërrimi i vajit

Kontroll vizual i gjëndjes së përgjithshme të gjeneratorit,

Kontroll i jashtëm i gjëndjes së motorrit,

Kontroll i jashtëm i gjëndjes së gjeneratorit,

Kontroll i tubacioneve të sistemit të furnizimit me karburant,

Kontroll i gjëndjes fizike dhe regjistrimi i rripave të transmetimit të lëvizjes,

Kontroll i kuadrit të automatikës që përmbledh kontrollin e sistemit të kontrollit të parametrave dhe atij të komandimit automatik,

Kontroll vizual i serbatorit për rrjedhje,

Kontroll i gjeneratorit për shpërndarje ngarkese nëpër fazë,

Kontroll i lëngut ftohës në radiator,

Kontroll i baterisë terminaleve, elektrolitit dhe niveli të tensionit të saj,

Testim i gjeneratorit në ngarkesë maksimale.

A/3 Verifikimi i POWER CENTER në Godinën Teknike B

Prova kampion i automatëve diferencial nëpërmjet pulsantit TEST,

Prova kampion e automatëve magneto-

termik nëpërmjet instrumentit përkatës për rrymat termike edhe të lidhjes së shkurtër,

Kontrolli termik i automatëve nëpërmjet instrumentit me INFRARED, i cili mundëson kontrollin në distance të tyre,

Prova me instrumentat elektronik për verifikimin e kohës së ndërhyrjes dhe parametrave

përkatës,

Prova e logjikës së funksionimit të POWER

CENTER, duke provokuar ndërhyrje të ndryshme në logjikën e funksionimit,

Verifikimi i funksionimit të llampave të sinjalizimit të POWER CENTER-it,

Kontrolli i gjëndjes të shkarkuesve të mbitensionit,

Kontrolli i lidhjes të saktë të kapikordave me kolektorin e tokës,

Verifikimi i tokëzimit etj.

A/4 Verifikimi i blindosbarrës kryesore të furnizimit të objektit

Verifikimi vizuali i gjithë linjës së blindosbarrës kryesore të furnizimit (3200A) për dëmtime mekanike apo korrozive.

Matja në mënyrë periodike e izolacionit nëpërmjet instrumentit përkatës me tension jo më shumë se 2000Volt,

Verifikimi i të gjitha parametrave teknik të blindosbarrës nën tension pa ngarkesë,

Verifikimi i të gjitha parametrave teknik të blindosbarrës nën tension me ngarkesë të plotë.

A/5 Verifikimi i POWER CENTER në godinën teknike A.

Prova kampion i automateve diferencial nëpërmjet pulsantit TEST,

Prova kampion e automatëve magneto-

termik, nëpërmjet instrumentit përkatës për rrymat termike dhe të lidhjes së shkurtër.

Prova me instrumentat elektronik për verifikimin e kohës së ndërhyrjes dhe parametrave përkatës,

Prova e llogjikës së funksionimit të POWER

CENTER, duke provokuar ndërhyrje të ndryshme në llogjikën e funksionimit,

Verifikimi i funksionimit të llampave të sinjalizimit të POWER CENTER-it,

Kontrolli i gjëndjes të shkarkuesve të mbitensionit,

Kontrolli i lidhjes të saktë të kapikordave me kolektorin e tokës,

Verifikimi i tokëzimit etj.

A/6 Verifikimi i paisjeve të UPS1, 2, 3

Pastrimi i gjithë pjesëve të brëndshme të pajisjes,

Kontrollin funksional të parametrave të pajisjes së bashku me matjet përkatëse,

Kontroll dhe verifikim i anës cilësore të baterive që garanton kohëmbajtjen e pavarur të ngarkesë s së punës nga burimet e tjera të rrymës alternative, që janë linja nga OSHEE dhe gjeneratori.

Kontrolli i funksionimit të linjës BY- PASS,

Shtërngimi i morseterisë,

Kontrolli i cilësisë të mbrojtjes të furnizimit me energji të pajisjes, si dhe asaj të transmetuar,

Verifikimi i gjëndjes të sistemit të tokëzimit duke iu referuar tokëzimit kryesor të objektit në të cilën është e instaluar UPS.

Në të gjitha rastet si me bateri të inkluduara në UPS ashtu edhe me bateri të jashtme kryhet ndarj a e linjës pozitive nga ajo negative dhe bëhet matja e kapacitetit të dy linjave.

Shtrengimi i të gjithë urave të lidhjes së baterive në seri,
Kontrolli dhe pastrimi i poleve të baterive.

A/7) Verifikimi i impiantit të ndricimit të sigurisë së emergjencës:

Prova e ndërhyrjes automatike në mungesë të rrjetit OSHEE,
Testimi i kohëzgjatjes së ndricuesave të emergjencës,
Zëvendësimi i llampave të emergjencës në rast të dëmtimit të tyre,
Zëvendësimi i paketës së baterisë së emergjencës në rast dëmtimi,

A/8 Kontrolli i kuadrove elektrik në nivel kati si dhe kuadrot kryesore të shpërndarjes.

Prova kampioni i automatëve diferencial nëpërmjet pulsantit TEST,
Prova kampioni e automatëve magnetotermik nëpërmjet instrumentit përkatës për rrymat termike dhe të lidhjes së shkurtër,
Kontrolli termik i automateve nëpërmjet instrumentit me INFRARED, i cili mundëson kontrollin në distancë të tyre,
Prova me instrumentat elektronik të matjes, për verifikimin e kohës së ndërhyrjes dhe parametra ve përkatës,
Kontrolli i gjëndjes të shkarkuesve të mbitensionit,
Kontrolli i lidhjes të saktë të kapikordave me kolektorin e tokës,
Verifikimi i tokëzimit etj.

A/9 Verifikimi i impiantit të ndricimit godinës A dhe B

Kontrolli vizual i impiantit të ndricimit,
Testimi i qarqeve të komandimit të ndricimit,

A/10) Verifikimi i sistemit të sinjalizimit të zjarrit.

Prova në kampioni e sensorëve të tymit me anë të bombulës së testimit,
Pastrimi i sensorëve me anë të mjeteve të nevojshëm për këtë qëllim,
Zëvendësimi i sensorëve në rast të dëmtimit të tyre,
Verifikimi i paneleve lokal të sinjalizimit të zjarrit të ndarë në nivel kati,
Verifikimi i magnetëve të dymit duke bërë edhe mirëmbajtjen e rastit,
Testimi i sistemit të sinjalizimit të zjarrit me sektorë lokal, për të parë gjithë veprimet automatike që sistemi i zjarrit duhet të kryejë,
Verifikimi i ushqyesave lokal që furnizojnë me energji magnetët e dymit,
Verifikimi i sistemit audio të EVAKUIMIT në rast zjarri.

A/11 Verifikimi i sistemit të thirjes së infermierisë.

Kontrolli vizual i paisjeve të sinjalizimit të infermierisë,
Testimi i paisjeve dhe verifikimi i thirjes nga dhoma deri në sallën e infermierisë.

VEPRIME MUJORE.

Përsëritja e veprimeve (javore) dhe gjithashtu:

B/1 Verifikimi i shtrënguar i morsetave dhe të pikave të pajisjeve të instaluar në borde, në kuadrin kryesor dhe kuadrot e tjerë elektrik të shpërndarjes.

B/2) Pastrimi komplet i lokalit teknik, kabinës, pajisjeve të kuadrit, kuadrot kryesore, kuadrove dytësore, për të eliminuar grumbullimet e pluhurave në të gjitha pajisjet e instaluara në to, duke përdorur fshesën me korent, një kujdes i veçantë duhet të ushtrohet në pastrimin e grilave të ventilimit, të instaluara si në makineri dhe në faqet e saj.

VEPRIMET TRE-MUJORE

Përsëritja e veprimeve, javore dhe mujore, si dhe:

C/1) Kabina e transformimit me trasformator të thatë:

- Kontrolli si në lidhjen "A"

C/2) Prova e ndërhyrjes së paisjeve ckycese të

- Panelit të TU.
- Çkycja e kabinës së transformatorit

Ngarkesat e lidhura nga gjeneratori me funksionim të njëkohshëm (prova e C'kycjes automatike edhe manuale).

Verifikimi i funksionimit të llampës së sinjalizimit të qarqeve c'kycese.

Janë parashikuar zërat të furnizim vendosje, pjesë material për sistemin e sinjalizimit të zjarrit, sitemit të evakuimit, kuadrove elektrike, si në Qëndrën teknik B, ashtu dhe A, dhe A1 e A2.

Nga niveli -1 deri në nivelin +2, janë 8 dhoma teknike në nivel kati në 2 godinat: A1 dhe A2 janë panele 0.4kv, ku magjistralet kryesore dalin nga qendra teknike B, në nivelin bodrum dhe drejtohen në 2 drejtime godinash A1 dhe A2, për 4 nivele kate. Panelet janë me automatë 3 fazore 4 polar fuqie, të cilat shpërndajnë po në nivel kati.

Për këto panele janë parshikuar, Furnizim-Vendosje automat, si më poshtë:

Furnizim vendosje automat 1P+N, TIP C6KA DPN 6A,10,16A, 20A, 32A, 40A.

Furnizim vendosje automat 3P+N, TIP C6KA DPN 10A,16A, 40A, 32A.

Furnizim vendosje automat DC 2P C10KA C60H, 16A, 20A, 40A 63A

Furnizimi vendosje automat 4P D10KA C60H 10A, 20A, 32A, 40A, 80A, 100A, 125A.

Furnizim vendosje llamba neoni 18w, 36, 58w, drozela e startëra, për ambjentet në qendrat teknike transformimit B.A, A1 A2 dhe në nivele kate .

Në sistemin e sinjalizimit të zjarrit është parashikuar :

Furnizim vendosje sensore tymi, sirenë temperaturë të adresueshme.

Furnizim vendosje ushqyes për magnetet e dyerve 24v 2,5A.

Furnizim vendosje magnet dyersh,

Furnizim vendosje pulsant sinjalizimi ndaj zjarrit.

Për moto-gjeneratorët automatik të tipit C.T.M job 6830, me panel automatike, Marka GARIBOLDI janë parashikuar jo vetëm shërbimet periodike javore, mujore , 3 mujore dhe 6 mujore, sipas specifikimeve teknike por dhe zëra të karakterit furnizim vendosje si:

Furnizim vendosje filtra naftë, ajri, bateri 250A, 24V dhe vaj, sipas karakteristikave në vend.

Kontrolli i kuadrit të automatikës që përmbledh kontrollin e sistemit të kontrollit të parametrave dhe atij të komandimit automatik të 2 gjeneratorëve. Është shumë e rëndësishme programimi i saj.

Në preventiv është parashikuar fond për pjesë këmbimi të castit të cilat do të jenë për difektin e castit e të pritëshëm. Në qëndrën teknike POWER CENTER në godinën A, për 3 UPS, të cilat kanë që nga vitit 2011 e vazhdim, që nuk i është ndërruar asnjë pjesë të rëndësishme, si bateritë si dhe në pjesën e automatikës që ndodhet po në këtë qëndër, automati i fuqisë 4 polar që bën automatikën kalimin e seksioneve me furnizim me transformatorë të ndryshëm .

Ky zë do të zbatohet me urdhër të vecantë, ku më parë të jetë bërë proces verbali i difektit , të miratuar nga drejtoria dhe të jetë i shoqëruar me analizë përkatëse.

Shërbimet dhe riparimet, që do të kryhen janë të përshkruara në preventivat bashkëngjitur,

Riparimet e çastit duhet të kryhen me marrjen e njoftimit.

Për çdo shërbim e riparim, që do të kryhet hapet urdhër pune me preventiv bashkëngjitur, i cili merret nga preventivi fitues.

Kërkesat teknike për sistemin e furnizimit me energji elektrike nga rrjeti dhe motogjeneratorët janë:

- 1- Operatorët ekonomik duhet të njihen me preventivin e punimeve, gjendjen faktike të kabinave, moto-gjenerator dhe të deklarojnë që marrin përsipër mirëmbajtjen e tyre.
- 2- Operatori ekonomik të kenë persona përgjegjës inxhinier elektrik, që të përgjigjen për riparim defekteve në cdo kohë dhe të kenë shërbim 24 orë, ditë të shtuna, diela e festa zyrtare , për riparimet e castit duhet të kryhen me marrjen e njoftimit ndërsa për shërbimet periodike kryhen periodikisht cdo muaj sipas urdhërit të punës.
- 3- Operatori ekonomik, duhet të kontaktoje cdo ditë me personat përgjegjës të Sektorit Teknik dhe duhet të raportojnë për anomali apo defekte gjatë natës.
- 4- Operatori ekonomik do të emërojë një person përgjegjës të sigurisë në punë, një përgjegjës për të vëzhguar, sic është përshkruar më sipër për punimet për ti komunikuar

- normat e parashikura nga QSUT-ja .
- 5- Operatori ekonomik do të angazhojë për shërbimet e mirëmbajtjes të Impiantit- elektrik të QSUT-së, një staf të specializuar, të punësuar pranë firmës konform ligjeve dhe rregullave në fuqi.
 - 6- QSUT-ja jep ndihmën teknike Operatorit ekonomik, në rast të difekteve me azhornime dhe Operatori ekonomik duhet që në çdo rast të paraqes ndryshimet në këto azhornime.
 - 7- Operatoriekonomik,angazhohet të kryejë shërbimet për mirëmbajtjen e impiantit elektri të QSUT në një kohë sa më të shkurtër, për të bërë të mundur njëkohë sa me minimale të ndërprerjes së furnizimit me energji elektrike kur kjo të jetë e domosdoshme.
 - 8- Operatori ekonomik do marrë përsipër që, në rast madhor të një defekti të rëndë të djegjes së një transformatori, të japë furnizim me energji duke montuar transformatorin rezervë që disponon QSUT në bashkëpunim me specialistë të energjitikës.

**Kërkesat teknike mbi sistemin e furnizimit me energji elektrike të sistemit të orëve diktim-sinjalizimi i zjarrit në Spitalin e Ri
Ofertuesi**

Të

kryejë të gjitha shërbimet e nevojshme të verifikimit dhe kontrollit, nga personeli i saj i specializuar dhe i kualifikuar sipas normave të mirëmbajtjes.

Të përgatisë dhe të japë QSUT-së, një informacion të detajuar të impiantit elektrik, në të cilin do të evidentojë:

- a. Përshkrime tregtare dhe karakteristikat e veçanta të gjithë produkteve,
- b. Ndërhyrjet jo të parashikuara nga plani i mirëmbajtjes,
- c. Numrin e saktë të të gjitha shërbimeve të realizuara, dhe atyre të kërkuara dhe të parashikuara nga plani mirëmbajtjes.

Sipërmarrësi, angazhohet të kryejë shërbimet për mirëmbajtjen e impiantit elektrik, në një kohë sa më të shkurtër, për të bërë të mundur një kohë sa më minimale të ndërprerjes së furnizimit me energji elektrike, kur kjo të jetë e domosdoshme.

Të gjitha furnizimet dhe punët duhet t'i përgjigjen:

**Normave të standartit elektrik Shqiptar si dhe normave të Bashkimit Europian (CEI)
Shërbimi i mirëmbajtjes duhet të kryhet nga personel teknik i përgatitur dhe i specializuar.**

QSUT, ka të drejtën të kontrollojë aftësitë e personelit teknik të firmës mirëmbajtëse .

Sipërmarrësi, do të paraqesë planin e sigurisë të punës, sipas normave në fuqi.

Sipërmarrësi, do të emërojë një person përgjegjës të sigurisë në punë, një përgjegjës për të vëzhguar, punimet për t'i komunikuar normat e parashikuara nga QSUT-ja.

Sipërmarrësi, është përgjegjës, për cdo dëmtim të shkaktuar, si pasojë e punimeve të kryera jo në përputhje me procedurat e kërkuara.

Sipërmarrësi do të angazhojë për shërbimet e mirëmbajtjes të impjantit elektrik të QSUT-së, një staf të specializuar, të punësuar pranë firmës konform ligjeve dhe rregullave në fuqi.

Stafi teknik i firmës duhet të ketë staf të specializuar inxhiniero-teknik, ku inxhinier elektrik duhet të jetë i pranishëm cdo ditë, stafi i mesëm elektrikist duhet të jetë me grup sigurimi teknik të dhënë nga ISHTI.

Firma e mirëmbajtjes do të sigurojë gadishmërinë teknike çdo orë, çdo ditë të shtuna, të diele dhe festa zyrtare,

Për anomalinë apo ndërprerje të energjisë elektrike, firma njofton brenda 30 minuta, stafin elektrik të QSUT-së dhe menjëherë, duhet të jetë në shërbim të këtij spitali ku manovron dhe bashkëpunon me specialistët e OSHEE Shpërndarje.

Për cdo anomali a defekt në të gjithë sistemet sipërmarrësi duhet të përgjigjet menjëherë dhe të bashkëpunjë në stafin elektrik të QSUT-së.

Ofertuesit duhet të njihen me këto sisteme dhe të deklarojnë me shkrim, të nënshkruar dhe vulosur, që marrin përsipër kryerjen e këtyre riparimeve dhe shërbimeve mirëmbajtëse në çdo orë gjatë gjithë ditëve kalendarike në afatin e dhënë në “Urdhërin e Punës”, të lëshuar nga Sektori Teknik i QSUT dhe me cilësinë e kërkuar për Shërbim Spitalor.

Ofertuesit duhet të kontaktojnë çdo ditë me përfaqësuesin e QSUT-së, për ndjekjen e zbatimit të kontratës.

Kohëzgjatja e kontrates: nga nënshkrimi deri më 31.12.2018.

Specifikimet teknike

Lotin 3 – Riparim Mirëmbajtje e Sistemeve të Ngrohjes dhe të ujit sanitar me kaldaja, sistemeve të ngrohjes-ftohjes me chillera, të stacionit qendror të pompave dhe sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm, të elektropomave, në godinat e shërbimeve spitalore në QSUT;

Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” ka këto sisteme ngrohje, ujë sanitar dhe ujë të pijshëm, që jepen me të gjitha specifikimet e nevojshme teknike në tabelat bashkëngjitur (inventaret e impjanistikës me të dhënat e tyre).

Kaldajat për ngrohje dhe impiantet e ujit sanitar, stacione dhe pompa për ujë të pijshëm, sisteme dhe impiantet uji MNZSH, sisteme te ujit sanitar:

Fuqia dhe marka e kaldajave siç shihet nga tabelat bashkëngjitur, janë të madhësive nga 170 kw në 2.550 kw; sprucatorët janë të tipeve të ndryshme, po kështu edhe kokat e sprucimit të lëndës djegëse janë me përmasa të ndryshme.

Për të gjitha sistemet, lënda djegëse është gazoil dhe kjo kërkon që:

Kokat e sprucatorit 3,5x45 gradë dhe 12x45 gradë, si dhe pompat e presionit të lartë deri në 40 bar, filtërat e lëndës djegëse, si dhe të gjithë pjesët e ndërrimit të kaldajave janë për kaldaja me naftë] (gasoil).

Firma mirmbajtëse do të kryejë shërbim, duke zbatuar të gjitha procedurat e nevojshme për këto sisteme, si: auditim (njohje) të sistemeve, shërbime periodike, mirëmbajtje sipas grafikut të shoqëruar me urdhëra pune, si dhe zëvendësimin e pjesëve të këmbimit të shoqëruar me urdhëra pune.

Në preventivin e punimeve janë parashikuar edhe zëvendësimi i tubave të tymit prej materiali çelik, rezistent ndaj temperaturave të larta, të një kaldaje ne fuqi 2550 kw, me diametër të brendshëm Ø57 dhe të jashtëm Ø65, me l-2870, copë 70.

Për këtë, duhet të merret parasysh që oxhaku që është i lidhur në mënyrë të ngurtë me kapakun e pasëm të kaldajës, duhet të ç'montohet me prerje dhe të rimontohet. Do të kërkohet gjithashtu:

Kontrolli i jashtëm i gjëndjes së manometrave të presionit, të termostateve, paneleve elektrike të punës dhe komandimit, etj..

Për sistemet e ujit të pijshëm do të kryhen riparimet e kërkuara në preventiv dhe çdo shërbim apo riparim i nevojshëm për funksionim të stacioneve të ujit të pijshëm 24/24 orë. Elektropompat janë të tipeve dhe të fuqive të ndryshme (shih tabelën përkatëse).

Në preventivin e punimeve është parashikuar edhe zëri riparim i defekteve të paparashikuara (të çastit), që duhet kryer me marrjen e njoftimit. Shërbimet teknike do të kryhen ditë të shtuna e të diela, pa penguar kryerjen e aktivitetit spitalor.

a) Parashikimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” ka katër reparte kaldajash, sisteme furnizimi me ujë sanitar dhe stacion me depo qendrore për ujë të pijshëm si më poshtë:

1. Reparti Qëndror, që ndodhet përballë Spitalit Nr.1 dhe shërben për ngrohjen e Spitalit Nr.1, Spitalit të Kardiokirurgjisë, ujë sanitar për dy godinat e Spitalit Pediatri, Labororit Klinik-Biokimik pranë Spitalit Pediatri e Re, Dermatologjisë, Zyrrave të Drejtorisë, Zyrrave të Farmacisë Qëndrore, Spitalit Djegje-Plastikë, Spitalit Nr. 2 (Kirurgji e Përgjithshme), Spitalit Infektiv, Labororit Anatomi-Patologji, Spitalit Onkologjik. Ky repart furnizon me ujë sanitar dy godinat e Pediatrisë dhe Djegje-Plastikës. Në repart janë të instaluar 3 (tre) kaldaja me prodhimtari nxehtësie 2.000.000 k.kalori/orë secila dhe shfrytëzohen në mënyrë të alternuar duke qënë në punë vazhdimisht një kaldajë. Lënda djegëse është gazoil, pra filtërat dhe të gjithë pjesët e ndërrimit të kaldajave janë për kaldaja me naftë.
2. Reparti i kaldajave të Neurokirurgjisë i cili shërben aktualisht vetëm për sezonin e ngrohjes. Ka të instaluar 2 (dy) kaldaja me prodhimtari nxehtësie respektivisht 1x210.000 dhe 1x450.000 k.kalori/orë. Lënda djegëse është gazoil, pra filtërat dhe të gjithë pjesët e ndërrimit të kaldajave janë për kaldaja me naftë. Parashikohet të funksionojë edhe ujë sanitar.
3. Reparti i kaldajave në Neurologji i jep ngrohje edhe Psikiatrisë. Gjatë periudhës tjetër,

dërgon ujë sanitar në Neurologji. Ka të instaluar 1 kaldaja me prodhimtari nxehtësie 1x450.000 k.kalori/orë dhe një impiant-shkëmbyes nxehtësie, enë zgjerimi dhe grup elektropompa. Lënda djegëse është gazoil, *pra filtërat dhe të gjithë pjesët e ndrrimit të kaldajave janë për kaldaja me nafte.*

4. Reparti i kaldajave në Spitalin Francez (të specialiteteve) shërben për ngrohje dhe ujë sanitar (në këtë spital nuk ka boliera për ngrohje uji) ka dy kaldaja me prodhimtari nxehtësie 2x450.000 k.kalori/orë. Nga ky repart merr ngrohje Spitalit Francez, Konsultat e Përgjithshme dhe Laboratorit Imunologjik gjatë sezonit të ngrohjes dhe i jepet ujë sanitar vetëm Spitalit Francez gjithë vitin. Lënda djegëse është gazoil, *pra filtërat dhe të gjithë pjesët e ndrrimit të kaldajave janë për kaldaja me nafte.*
5. Në Shërbimin e Neurokirurgjisë, Djegie-Plastikës dhe në dy godinat e Pediatriisë ka në funksionim këmbyes nxehtësie me aksesoret përkatës (elektropompa, panele komandimi, etj.), që duhet të rivihen në punë për furnizim me ujë sanitar gjatë gjithë vitit.
6. Për furnizim me ujë të pijshëm është në funksionim stacioni qëndror me dy depo nëntokësore (të lidhura si enë komunikuese. Në depo ka dy kundralvola Ø 200 mm, për fillimin e punës të elektropompave (thithjen). Vëllimi i depove është 200 mc secila. Janë të instaluara **8 elektropompa 11.5 kw** si dhe saracineskat Ø120 për secilën pompë dhe saracineskat Ø200 për linjate kryesore dhe dy kundralvova Ø 160 në thellësi të depove, që bëjnë të mundur vënien e pompave në punë (copë 26 gjithësej). Për furnizimin me ujë të godinave të Shërbimit të Pediatriisë, Kardiokirurgjisë, Neurokirurgjisë, Neurologjisë dhe Psikiatriisë ka grupe depozitash, dhe furnizimi me ujë bëhet me elektropompa me fuqi nga 2,2 deri 7.5 kw. Për Spitalin 6-katësh (Spitali Nr.1) shërben një elektropompë 7,5 kw, për Onkologjikun–1 elektropompë 5.5 kw dhe për Infektivin – 1 elektropompë 5.5 kw. Gadishmsëria e elektropomave kërkohet 24 orë në 24 orë, dhe gjatë gjithë ditëve të vitit.

b) Grafiku i Lëvrimit

Mirëmbajtja dhe riparimet janë me karakter mekanik dhe elektrik, për linja dhe panele komandimi.

Shërbimet teknike dhe riparimet **do të kryhen sipas “urdhërave të punës”** të shoqëruar me preventivin përkatës, për të cilat çmimet do të merren nga kontrata dhe do lëshohen nga Sektori Teknik, i cili ndjek dhe zbatimin e tyre në kohë e cilësi.

Shërbimet periodike (teknike) dhe riparimet do të kryhen pa penguar aktivitetin spitalor. Riparimet për defektet e çastit duhet të kryhen menjëherë me marrjen e njoftimit.

Në repartin e ngrohjes qëndrore të qendrës teknike qëndrore, (pranë kolektorëve kryesor të ujit të nxehtë) do të zëvendësohen tubat e tymit sipas kërkesave të preventivit, brenda afatit 01 Shtator 2018.

Sipërmarrësi do të ketë përfaqësuesin e tij në QSUT (Sektorin Teknik), për të marrë dhe zbatuar detyrat ditore për riparime dhe mirëmbajtje.

Operatori ekonomik duhet të njihet me këto sisteme, gjëndjen e tyre teknike dhe të deklarojë se merr përsipër riparim-mirëmbajtjen e tyre, sipas specifikimeve teknike dhe sipas kushteve spitalore. Njohja e gjëndjes dhe kërkesave spitalore bën që operatori ekonomik të jetë real në paraqitjen e ofertës teknike.

Sistemi i ngrohjes – ftohjes me chiller dhe kaldajë, prodhimit të ujit sanitar dhe avullit, sistemi ventilim – kondicionimit dhe trajtimit të ajrit në Spitalin e Ri.

Spitali i Ri, ka një Qendër Teknike (Godina B), ku janë instaluar sistemet qendrore të ngrohjes, të ujit të ngrohtë, të avullit për sterilizim, kondicionimit, oksigjenit, protoksid azotit dhe kabina elektrike 20/0.4 kV e përbërë nga 3 trasformatorë me fuqi 1000 kwh.

Sistemi i Ngrhjes dhe Ftohjes, janë projektuar dhe zbatuar me impiante qendrore të instaluar në ndërtesën teknike, po kështu funksionojnë edhe kaldajat e prodhimit të ujit sanitar dhe të avullit.

Në këtë sistem ndodhen këto paisje:

1. Kaldajë ngrohje me prodhim nxehtësie max/min 1535/2,360 kE, copë 1(një).
2. Kaldajë ngrohje me prodhim nxehtësie max/min 820/540 kE, copë 1(një).
3. Gjeneratori indirekt i avullit, që shërben për sistemin e kondicionim dhe ventilimit.
4. Çillera me ajër të ftohtë me shpejtësi të variushme, kapaciteti ftohës 103, EER 3.02, Refroxhant R=134 A, Fuqi 348 kE, copë 3 (tre).
5. Paisja qendrore e kondicionimit të ajrit është instaluar me ajër dhe me ujë.
6. Sistemi i ujit sanitar i përbërë nga një sistem pompash, këmbyesish nxehtësie 2 x 5000 litra dhe paisjesh kontrolluese dhe matëse.
7. Sistemi i furnizimit me ujë të paisjeve të MNZSH, është i përbërë nga një sistem pompash dhe motogjeneratorësh, që furnizojnë me energji elektrike sistemin e pompave të MNZSH, në rast ndërprerje të energjisë elektrike.
8. Sistemi i depozitave nëntokësore të furnizimit me karburant 40 m³ secila, dhe janë të instaluar 3 pompa dërgimi lënde djegëse në depozitën ditore 5.000 litërsh, në repartin e kaldajave.

Mirëmbajtja e këtyre sistemeve kërkon kryerjen e shërbimeve teknike dhe të riparimeve të çastit (emergjente) si më poshtë :

Mirëmbajtja dhe riparimet e sistemeve të ftohje-ngrohjes, të prodhimit të ujit sanitar, avullit dhe paisjeve të MNZSH, kryhen sipas preventivit pjesë përbërëse e kontratës.

Gjatë zbatimit riparim-mirëmbajtja kryhet me “Urdhëra Pune“, të lëshuar nga specialistët përkatës të Sektorit Teknik të QSUT, dhe në përfundim të shërbimeve teknike apo riparimeve hartohet proces verbali i marrjes në dorëzim ku nënshkruajnë të dy palët.

Duhet të sigurohet gadishmëri teknike dhe shfrytëzimi 24/24 orë, dhe me temperaturë të brendshme 20 - 22 °C.

“Urdhëri i Punës“ për riparime të defekteve të çastit shoqërohet me preventiv të hartuar nga

përfaqësuesi i QSUT-së dhe nënshkruhet edhe nga Sipërmarrësi, i cili merr përsipër zbatimin në afat e me cilësi të detyrave të dhëna në „Urdhërin e Punës“.

Preventivi përmban njësinë, sasinë, çmimin, vlerën dhe kohën e kryerjes së riparimit të defekteve; çmimet merren nga oferta fituese, që është pjesë përbërëse e kontratës.

Kontroll dhe shërbim periodik mujor jepen në urdhërin e punës nga përfaqësuesi i QSUT-së dhe përfshihen:

- Pastrimi dhe mirëmbajtje filtrash çdo 20 (njëzet) ditë,
- Zëvendësimi i filtërave të dëmtuar (sipas specifikimeve teknike)
- Pastrimi brënda dhe jashtë e baterive të shkëmbimit nxehtësisë çdo 30 (tridhjetë)ditë,
- Kontrolli i presionit dhe plotësimi i sasisë së gazit freon çdo 15 (pesëmbëdhjetë) ditë,
- Kontrolli dhe plotësimi i vajit;
- Kontrolli, larje-pastrimi i serpentinave dhe aksesorëve të tjerë çdo muaj, cdo 30 (tridhjetë)ditë ;
